



Republika e Kosovës

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRIPISË - OPSTINA VUŠTRIN
01 Nr. / Br. 278/15
Nr. i fq. / Br. sht. -23-
Data: / Datum 30. 12. 2015
VUŠTRIN - VUŠTRIN



Kuvendi i Komunës - Vuštrri

**REGULLORE
PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE**

Dhjetor 2015

Në bazë të nenit 8 pika (a) të Ligjit Nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 12 pika (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 41.2 pika (c) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më: **30 dhjetor 2015**, miratoi këtë:

RR E G U L L O R E **PËR TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë lartësinë e tarifave dhe ngarkesave për shërbime administrative të komunës, që u ofrohen personave fizik dhe juridik të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të lëshimit të dokumenteve publike; përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale, sipas kërkesave të palëve apo sipas detyrës zyrtare; ushtrimin e veprimtarisë afariste; shërbime profesionale për pronësinë e automjeteve motorike; përdorimin apo shfrytëzimin e pronës së komunës; tarifave për çështje të planifikimit dhe urbanizmit; si dhe të hyrave nga qiradhënia.
2. Taksa për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste caktohet për secilin lokacion, ku ushtrohet një veprimtari afariste brenda kufijve të komunës, nëse një shoqëri tregtare ushtron veprimtari afariste në më shumë se në një lokacion në komunë.
3. Komuna nuk do t'i lejojë asnjë personi ose ndërmarrjeje e cila nuk është e regjistruar në regjistrin e biznesit të Kosovës, që të ushtrojë veprimtarinë afariste brenda komunës, përveç kur personi ose ndërmarrja dëshmon se janë të liruar nga ky regjistrim në bazë të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëri Tregtare.

Neni 2 **Inkasimi i të hyrave**

1. Inkasimi i të hyrave komunale, sipas kësaj rregulloreje, apo ndonjë urdhërese administrative, udhëzimi administrativ, të nxjerra nga ndonjë institucion tjetër qendror do të bëhen në çdo muaj, në gjashtë muaj apo në fund të vitit, varësisht prej natyrës së tyre dhe ato do të deponohen në buxhetin e komunës.
2. Sipas kësaj rregulloreje, drejtoritë përgjegjëse obligohen që të mbajnë evidencë për pagesat në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3
Lartësia e tarifave dhe ngarkesave komunale

Lartësia e tarifave dhe ngarkesave komunale që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që iu ofrohen, do të caktohen sipas drejtorive përkatëse.

| 1. Taksat/tarifat për lëshimin e certifikatave zyrtare në Drejtorinë për Administratë | | |
|--|--|----------------------------|
| N/r | Shërbimet (dokumenti) | Lartësia e taksës € |
| 1.1. | Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile | 1.00 |
| 1.2. | Vendimi për ndërrimin e emrit personal | 20.00 |
| 1.3. | Vendimi për korrigjimin e të dhënave personale në regjistrat e G.J.C. | 1.00 |
| 1.4. | Vendimi për regjistrim të mëvonshëm të lindjes, vdekjes ose anulim të tij | 3.00 |
| 1.5. | Procedura-ceremonia e kurorëzimit | 10.00 |
| 1.6. | Ceremonia e kurorëzimit jashtë orarit të punës | 20.00 |
| 1.7. | Ceremonia e kurorëzimit jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së organit | 50.00 |
| 1.8. | Aplikimi për fitim ose lirim nga shtetësia | 5.00 |
| 1.9. | Vërtetime të ndryshme | 1.00 |
| 1.10. | Vërtetim identik me origjinalin (një kopje) | 1.00 |
| 1.11. | Shërbimet jashtë selisë së organit (sigurimi i transportit-automjetit) | 10.00 |
| 1.12. | Gjetja – sigurimi i dokumenteve në arkivin e drejtorisë | 2.00 |
| 1.13. | Lëshimi i dokumenteve me foto | 1.00 |
| 1.14. | Fotokopjimi i dokumenteve për nevojat e qytetarëve, për një faqe | 0.20 |
| 2. | <p>Nga taksat për pagesa për shërbimet e kryera nga neni 3 pikat 1.1., 1.3., 1.4., 1.9., 1.10., 1.11., 1.12., 1.13 dhe 1.14. lirohen kategoritë si më poshtë:</p> <p>a) Familjet e dëshmorëve (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët e dëshmorëve deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>b) Shfrytëzuesi i ndihmës sociale (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>c) Invalidët e luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>ç) Veteranët e luftës së UÇK-së (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>d) Familjet e viktimave të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>dh) Invalidët civil të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>e) Të burgosurit politikë (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt), pasi që pala-kërkuesi të paraqesë dëshminë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbi statusin përkatës;</p> <p>ë) Handikos-i, shurdhmemecët dhe të verbërit;</p> | |
| 3. | Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Vushtrrisë në bazë të UNIREF-it. | |

Neni 4
Tarifat në sferën e shërbimeve publike

| | | |
|---|---|----------|
| 1. Tarifa vjetore për parkingje në pronë komunale, para ndërtesave dhe objekteve tjera janë: | | € |
| 1.1. | Kamionët, autobusët | 80.00 |
| 1.2. | Vetura, parkimi me veprimtari profitabile (biznes) | 80.00 |
| 1.3. | Kombibusët, tarifa vjetore | 48.00 |
| 1.4. | Veturat | 40.00 |
| 1.5. | Ndalja e veturave për ngarkim-shkarkim, ku ka hapësirë të mjaftueshme | 40.00 |
| 1.6. | Veturat taksi | 24.00 |
| 2. Parkingu kohor për 1 orë | | |
| 2.1. | Në parkingjet e KK-së | 0.30 |
| 2.2. | Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I | 0.30 |
| 2.3. | Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II | 0.20 |
| 3. Shfrytëzimi i trotuareve gjatë ndërtimeve dhe renovime të ndryshme, kompensimi ditor | | |
| 3.1. | Zona e I | 0.30 m |
| 3.2. | Zona e II | 0.20 m |
| 3.3. | Zona e III | 0.10 m |
| 4. Pagesa vjetore për regjistrim të automjeteve | | |
| 4.1. | Për automjetet që peshojnë deri në 3.5 t | 10.00 |
| 4.2. | Për automjetet që peshojnë mbi 3.5 t. | 20.00 |
| 5. Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese - tarifa vjetore për m² | | |
| 5.1. | Zona urbane | 30.00 |
| 5.2. | Zona jashtë urbane | 20.00 |
| 5.3. | Pllakatet (panot) reklamuese me ndriçim, paguhen me tarifë të shtuar | 30 % |
| 5.4. | Vendosja e reklamave elektronike – ekraneve | 150.00 |
| 6. Shërbime tjera | | |
| 6.1. | Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike në bazë të kërkesave të qytetarëve, për vendosjen e pengesave në rrugë | 25.00 |
| 6.2. | Leja për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24 orë | 25.00 |
| 6.3. | Leja për bllokim të rrugës – shiritit rrugor – trotuarit për 24 orë | 25.00 |
| 6.4. | Vërtetimi i rendit të udhëtimit - Operatori transportues paguan taksën për një vit për 1km. | 0.50 |
| 6.5. | Leja për hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 t, për 24 orë | 25.00 |
| 6.6. | Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për vendparkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtarë | 30.00 |
| 6.7. | Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore | 10.00 |
| 6.8. | Leja për prerjen e asfaltit në rrugë për metër katror | 50.00 |
| 6.9. | Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të paasfaltuara, parqeve, kubëzave të betonit, etj për metër katror | 25.00 |
| 7. | Nëse shfrytëzimi i reklamës bëhet më pak se 30 ditë, shtohet vlera për 100 %, kurse nëse pllakata është shumëkrahëshe, paguhet për çdo krah të dukshëm; | |

| | |
|----|---|
| 8. | Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar; |
| 9. | Nga pagesa për leje për mjete motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (ambulanca dhe makinat e zjarrfikësve). |

Neni 5
Taksa në firmë

1. Bankat komerciale..... 1.500 €;
2. Bastoret sportive..... 1.000 €.

Neni 6
Taksat dhe tarifat në sferën e urbanizmit

1. Lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore bazohet dhe llogaritet për m² të sipërfaqes BRUTO për ndërtim afarist dhe banimor;
2. Për shndërrimin e objekteve banesore në objekte afariste aplikohet taksë e njëjtë administrative e cila aplikohet për lëshimin e lejeve të ndërtimeve.
3. Identifikimi i parcelës në terren dhe dhënia e protokollit për objektet për të cilat nuk kërkohet leja e ndërtimit..... 15.00 €;
4. Tarifa për vendosjen e transmetuesve, antenave me frekuenca të ndryshme për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit dhe tjera të ngjashme në pronë private, paguhet tarifa paushall prej.....500.00 €;
5. Tarifa për vendosjen e transmetuesve, antenave me frekuenca të ndryshme për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit dhe tjera të ngjashme në pronë komunale, paguhet tarifa paushall prej.....700.00 €;
6. Taksë vjetore për transmetues, antena me frekuenca të ndryshme dhe objekte tjera të ngjashme, për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit paguhet taksa vjetore në zonën urbane prej.....500.00 €;
7. Taksë vjetore për transmetues, antena me frekuenca të ndryshme dhe objekte tjera të ngjashme, për nevojat e telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit paguhet taksa vjetore në zonën rurale prej.....300.00 €;
8. Për shtrirjen e rrjetit të përçuesve nëntokësor dhe mbitokësor kabllovik (elektroenergjetik dhe telekomunikacionit optik), çmimi kalkulohet:
 - 8.1. Shtrirja e rrjetit kabllor (ajror) të internetit, telefon dhe të ngjashme0.60 € m/l;
 - 8.2. Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore (vendosja e rrjetit kabllovik–internet, telefonik dhe të ngjashme).....0.50 € m/l.

- 8.3. Në rastet kur operatori shfrytëzon infrastrukturën nëntokësore të ndërtuar nga komuna.....1.00 € m/l;
- 8.3. Shtrirja e rrjetit elektrik-ajror.....0.50 € m/l;
- 8.4. Shtrirja e rrjetit elektrik nëntokësor.....0.20 € m/l;
- 8.5. Me rastin e zëvendësimit të rrjetit elektrik ajror me rrjetin elektrik nëntokësor, operatori lirohet nga taksa administrative;
- 8.6. Për vendosjen e ormanëve shpërndarës dhe të ngjashme në prona publike dhe private, me pëlqim nga pronari.....50.00 €/copë;
- 8.7. Për shfrytëzime tjera të hapësirës komunale-ekspozimi (reklamimi) për 1 m², tarifa mujor.....10.00 €;
- 8.8. Vendosja e foltores telefonike.....120.00 €;
- 8.9. Leja për shfrytëzime tjera të hapësirës komunale, ekspozimi-reklamimi ditor në tavolina, tenda të ndryshme për 1 m² – tarifa ditore.....2.00 €.

Neni 7

Kompensimi për shfrytëzimin e pronës komunale para lokaleve afariste (kompensimi mujor për m²)

1. Zona e parë2.00 €;
2. Zona e dytë.....1.50 €;
3. Zona e tretë.....1.00 €;
4. Zona e katërt.....0.25 €.

Neni 8

Lirimi nga pagesat për leje ndërtimore

Lirohen nga pagesat për marrjen e lejes ndërtimore:

1. Objektet për të cilat investues janë: institucionet shtetërore të Kosovës dhe institucionet komunale;
2. Objektet e karakterit të përgjithshëm shtetëror dhe publik;
3. Objektet e infrastrukturës teknike komunale;

4. Objektet e mbrojtjes shëndetësore, sociale, arsimit, shkencës, kulturës, artit, rekreacionit dhe sportit;
5. Objektet e ndërtuara me donacione;
6. Personat-investuesit, të cilët bëjnë adaptimin dhe renovimin e brendshëm, gëlqerosjen-ngjyrosjen e jashtme dhe përforcimin-ndërrimin e tjegullave të çatisë, në kuadër të gabaritit dhe etazhitetit të objektit ekzistues, të ndërtuar legalisht dhe pa ndërrim të destinimit;
7. Personat, të cilët janë të pajisur paraprakisht me leje ndërtimi për hapësirën, për të cilën posedon dëshmi (dokumente) se ka qenë i pajisur me leje;
8. Objektet fetare, nëse objektet e tilla nuk shërbejnë për afarizëm dhe përfitim.
9. Kryefamiljarët e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së lirohen nga pagesa e taksës komunale për marrjen e lejes ndërtimore për ndërtim të objektit banesor individual;
10. Kategoritë sociale, të cilave iu ndërtohen shtëpitë nga donatorët e ndryshëm apo nga komuna;

Neni 9

Tarifat për marrjen e lejes ndërtimore

1. Për lëshuarje të lejes së ndërtimit paguhet taksë administrative prej **2.54 € për m²**.
2. Me rastin e llogaritjes së lartësisë së taksës për leje ndërtimore për objekte të banimit, aplikuesi do të paguaj në të njëjtën kohë edhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës në shumë prej **2.52 € për m²** për hapësira të banimit.
3. Për lëshuarje të lejes për rrënim të objekteve ndërtimore aplikohet taksë komunale fikse prej pesëmbëdhjetë (15) euro.

Neni 10

Taksa për leje urbanistike

Për objektet e përkohshme aplikohet taksa administrative për m² në vlerë prej 2.54 €.

Neni 11 Tarifat për lejet mjedisore komunale

Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen tarifës për Leje Mjedisore Komunale:

1. Grupi i parë – 400 €:

- 1.1. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj, me kapacitet deri në 50 m³ beton/ditë;
- 1.2. Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vendprodhim;
- 1.3. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktimit, demolimit etj, për qëllime të riciklimit, përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre, si dhe caktimin e vendit për deponim.

2. Grupi i dytë - 300 €:

- 2.1. Pikëshitjet e gazit (GLN) deri 4.9 m³;
- 2.2. Furrat e bukës;
- 2.3. Thertore me kapacitet deri në 3 gjedhe /ditë;
- 2.4. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m²;
- 2.5. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000 m²;
- 2.6. Magazinat frigorifer për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 tonë;
- 2.7. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral dhe mineral, me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë;
- 2.8. Fabrika për prodhimin e lëngjeve të frutave (pije freskuese, alkoolike) me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë;
- 2.9. Fabrika për përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij deri në 1.000 kg në ditë;
- 2.10. Fabrika për përpunimin e vajrave bimore (luledielli) me kapacitet 500 l në ditë;
- 2.11. Fabrika për përpunimin e pemëve dhe perimeve deri në 1.000 kg në ditë;

2.12. Stacionet e karburanteve të benzinës me kapacitet deri në 49 m³;

2.13. Fabrikat për përpunimin e drurit (mobileri, tapiceri) deri në 1.000 m³ në vit.

3. Grupi i tretë - 200 €:

3.1. Sharrimi i lëndës drusore;

3.2. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit.

3.3. Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtime të imëta dhe të mëdha, që kanë më pak se:

a) 2000 shpendë;

b) 100 derra;

c) 30 gjedha;

d) 200 bagëti të imëta.

4. Grupi i katërt - 100 €:

4.1. Autoserviset;

4.2. Vendet ku janë të magazinuara më pak se 10 tonë mbeturinë inerte;

4.3. Vendet ku janë të magazinuara më pak se 2 tonë mbeturinë e parrezikshme;

4.4. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000 tonë/vit.

5. Grupi i pestë - 50 €:

5.1. Autolarjet;

5.2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri në 10 tonë;

5.3. Qebaptoret dhe gjellëtoret;

5.4. Vendet e tregtimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura;

5.5. Tregjet urbane, industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore.

6. Grupi i gjashtë – Projektet publike të liruara:

- 6.1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri në 5 km;
- 6.2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimi i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri në 5 km;
- 6.3. Rikonstruksioni i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);
- 6.4. Plantacionet e drunjve frutor;
- 6.5. Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzimeve dhe sistemime etj.

Neni 12

Dhënia në shfrytëzim e tokës ndërtimore me qira

1. Propozimin për dhënie të tokës ndërtimore me qira e paraqet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit përmes Kryetarit të Komunës;
2. Forma e dhënies së tokës ndërtimore në shfrytëzim me qira bëhet konform Ligjit Nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Rregullores Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale.

Neni 13

Tarifat e sferës së shëndetësisë

| Nr. | Shërbimet/aktivitetet | Lartësia e taksës € |
|---|---|---------------------|
| 1. Taksat në sferën e kujdesit parësor shëndetësor: | | |
| a) Shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) | | |
| 1.1. | Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë | 1.00 |
| 1.2. | Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF me udhëzim të mjekut familjar | 2.00 |
| 1.3. | Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes | 4.00 |
| 1.4. | Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente | 6.00 |
| 1.5. | Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike (për recetë) | 0.30 |
| 1.6. | Ultrazëri standard | 2.00 |

| | | |
|-------|--|-------|
| 1.7. | Radiografia (për një shërbim) | 2.00 |
| 1.8. | EKG | 0.50 |
| 1.9. | Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina | 1.00 |
| 1.10. | Analizat laboratorike (komplet) | 3.00 |
| 1.11. | Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 1.00 |
| 1.12. | Audiogrami | 1.00 |
| 1.13. | Shpërlarja e veshit | 1.00 |
| 1.14. | Dhënia e ineksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente | 1.00 |
| 1.15. | Dhënia e ineksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente | 1.00 |
| 1.16. | Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë) | 3.00 |
| 1.17. | Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor | 1.00 |
| 1.18. | Certifikata e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi profesionist | 18.00 |
| 1.19. | Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 18.00 |
| 1.20. | Dhënia e raportit mjekësor – vërtetimit ose dokumentit tjetër, në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 5.00 |
| 1.21. | Vërtetim që nuk ka detyrime financiare ndaj personave për ushqimin dhe mbajtjen (alimentacionin) | 5.00 |
| 1.22. | Certifikatë për zotësi veprimi | 5.00 |
| 1.23. | <p>Nga taksat për pagesa për shërbimet shëndetësore lirohen kategoritë si më poshtë:</p> <p>a) Familjet e dëshmorëve (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët e dëshmorëve deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>b) Shfrytëzuesi i ndihmës sociale (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>c) Invalidët e luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>ç) Veteranët e luftës së UÇK-së (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>d) Familjet e viktimave të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>dh) Invalidët civil të luftës (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);</p> <p>e) Të burgosurit politikë (prindi, bashkëshorti dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare, respektivisht 26 vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt), pasi që pala-kërkuesi të paraqesë dëshminë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbi statusin përkatës;</p> <p>ë) Handikos-i, shurdhmemecët dhe të verbrit;</p> <p>f) Viktimat e trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me Ligjin;</p> <p>g) Banorët e përhershëm të vendbanimeve jo formale në Republikën e Kosovës që nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në përfundim të procesit të regjistrimit;</p> <p>gj) personat e riatdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas riatdhesimit;</p> <p>h) të burgosurit të cilët janë në mbajtje të dënimit;</p> <p>i) personat e zhvendosur me dhunë jashtë shtëpive të tyre si viktimat e dhunës familjare, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në pajtim me ligjin;</p> | |

| | | |
|---|--|----------------------------|
| | j) dhuruesit e gjakut që posedojnë dëshminë e lëshuar nga Enti i Kosovës për Transfuzionin e Gjakut se kanë dhënë gjak së paku pesë (5) herë në dy (2) vitet e fundit. | |
| b) Shërbimet stomatologjike në nivelin e QMF-së | | Lartësia e taksës € |
| 1.1. | Vizita e parë stomatologjike | 1.00 |
| 1.2. | Rtg i dhëmbit | 1.50 |
| 1.3. | Mbushja e përhershme me amalgamë | 4.00 |
| 1.4. | Mbushja e përhershme me kompozitë | 5.00 |
| 1.5. | Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 5.00 |
| 1.6. | Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 6.00 |
| 1.7. | Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 6.00 |
| 1.8. | Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 6.00 |
| 1.9. | Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 6.00 |
| 1.10. | Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë) | 6.00 |
| 1.11. | Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme | 6.00 |
| 1.12. | Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës | 1.00 |
| 1.13. | Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave | 1.00 |
| 1.14. | Vulosja e fisurave | 1.00 |
| 1.15. | Mënjanimi i depozitimeve të buta | 1.00 |
| 1.16. | Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull) | 3.00 |
| 1.17. | Kiretazha e gjepave parodontal (një dhëmbë) | 1.00 |
| 1.18. | Nxjerrja e dhëmbit | 1.00 |
| 1.19. | Incizioni intra dhe ekstra oral | 1.50 |
| 1.20. | Heqja e kurorës me anë të prerjes | 1.00 |
| 1.21. | Riparimi i protezës (ngjitja) | 1.50 |
| c) Tarifat në sferën e kujdesit shëndetësor publik | | |
| 1.1. | Pëlqimi sanitar | 10.00 |
| 1.2. | Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit prej 5 deri në 100 kg dhe lëshimi i vërtetimit | 50.00 |
| 1.3. | Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit mbi 100 kg dhe lëshimi i vërtetimit | 100.00 |
| 1.4. | Shërbimi lidhur me konstatim, izolim, konfiskim dhe shkatërrim të mallit ushqimor, produkte tjera kozmetike dhe higjienike, në varësi nga sasia e mallit dhe lëshimi i vërtetimit (sipas kërkesës së palës) | 15.00 |
| 2. | Nga bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të ofruara, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e qytetarëve të parapara me nenin 61 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi. | |
| 3. | Çmimet për shërbimet shëndetësore të ofruara sipas nenit 13 për shtetasit e huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja, do të jenë për pesë (5) herë më të larta se sa për banorët e Kosovës. | |

Neni 14

Tarifat e sferës së ekonomisë, bujqësisë dhe pylltarisë

1. Certifikatë bujqësore.....1.00 €;
2. Certifikatë për shitjen e produkteve bujqësore.....1.00 €.

Neni 15

Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

1. Të gjithë personat fizik apo juridik, kompensimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e bëjnë para marrjes së lejes ndërtimore.
2. Mjetet e inkasuara nga kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nuk mund të përdoren për qëllime tjera, përveç për rregullimin e tokës brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë.
3. Shuma e kompensimit varet nga klasifikimi i tokës përkatëse. Nëse ndërrimi i kërkuar i destinimit ka të bëjë me tokën e:
 - 3.1. Klasës 1 – 4 kompensimi do të jetë 1.00 € për m²;
 - 3.2. Klasës 5 – 6 kompensimi do të jetë 0.75 € për m²;
 - 3.3. Klasës 7 – 8 kompensimi do të jetë 0.50 € për m².
4. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për klasën 1 – 6 bëhet pas konfirmimit nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit se ndërrimi i destinimit është në pajtim me Planin Hapësinor dhe Urban të Komunës.
 - 4.1. Në rastet kur parcela për ndërrim të destinimit gjendet jashtë kufijve të planit hapësinor – urban, kompensimi për ndërrimin e destinimit për klasën 1 – 6 bëhet pas nxjerrjes së vendimit nga kuvendi i komunës;
 - 4.2. Në rastet kur parcela për ndërrim të destinimit gjendet jashtë kufijve të planit hapësinor – urban, kompensimi për ndërrimin e destinimit për klasën 7 – 8 bëhet pas nxjerrjes së vendimit për ndërrimin e destinimit nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 16

Dhënia në shfrytëzim e tokës bujqësore me qira

1. Propozimin për dhënien e tokës bujqësore me qira e paraqet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes Kryetarit të Komunës;
2. Forma e dhënies së tokës ndërtimore në shfrytëzim me qira bëhet konform Ligjit Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Rregullores Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale.

Neni 17
Tarifa në sferën e arsimit

1. Tarifa për provime private në arsim është e caktuar dhe do të paguhet në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Kosovës.

2. Pagesa për parashkollorët në çerdhen “Foleja” në Vushtrri për një muaj është me sa vijon:

2.1. Për një fëmijë.....30.00 €;

2.2. Për dy fëmijë.....51.00 €;

2.3. Për tre fëmijë.....66.00 €;

2.4. Lirohet nga pagesa fëmija i katërt.

Neni 18
Tarifa në sferën e kulturës

1. Tarifa për anëtarësim në bibliotekën e qytetit “Naim Frashëri”

a) Pagesa për anëtarësi për lexues (nxënës) të shkollave të mesme, studentë dhe të tjerë.....2 €;

b) Pagesa bëhet njëherë në vit. Punëtori i autorizuar në bibliotekë i evidenton pagesat me bllok-serik;

c) Për një libër të humbur apo të dëmtuar skajshmërisht, lexuesit e të gjitha kategorive detyrohen ta blejnë atë libër dhe ta sjellin në bibliotekë;

d) Prej pagesës së anëtarësisë në bibliotekën e qytetit “Naim Frashëri” lirohen: të gjithë anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve të luftës dhe martirëve; lexuesit (nxënësit) e shkollave fillore, si dhe vullnetarët e pajisur me librezë të vullnetarizimit.

2. Tarifat arkivore

a) Kërkesa për lëshuarjen e dëshmive nga lënda arkivore.....1 €;

b) Lëshuarja e certifikatës/vërtetimit që nuk është liruar nga procedura e taksave për certifikatë/vërtetim.....3 €;

c) Lëshuarja e certifikatës të liruar nga pagesat sipas dispozitave ligjore të shërbimit publik-civil (familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës),.....pa pagesë;

ç) Fotokopjimi i dokumenteve:

2.1. për punë shkencore

2.1.1. një faqe A-4.....0.10 €;

2.1.2. një faqe A-3.....0.20 €;

2.1.3. një faqe A-O1 €.

2.2. për çështjet private të rregullimit të të drejtave civilo-juridike:

2.2.1. një faqe A-4.....1 €;

2.2.2. një faqe A-3.....1.50 €;

2.2.3. një faqe A-O.....3 €.

2.3. për institucione publike/private:

2.3.1. një faqe A-42 €;

2.3.2. një faqe A-33 €;

2.3.3. një faqe A-05 €.

2.4. për organizata humanitare dhe pensionistë:

2.4.1. një faqe A-40.10 €;

2.4.2. një faqe A-30.20 €;

2.4.3. një faqe A-O0.50 €.

d) Skanimi-digjitalizimi i dokumenteve:

1) një faqe A-4.....0.40 €;

2) një faqe A-3.....0.70 €.

e) Shtypja e dokumenteve (aty ku nuk është i mundur kopjimi):

1) një faqe0.50 €.

f) Shfrytëzimi i projekteve me procedurë të veçantë të sigurimit, me përcjellje të punëtorit arkivor, për një ditë30 €;

g) Regjistrimi në regjistrator i lëndës arkivore me të gjitha operacionet përkatëse të valorizimit, inventarizimit, etj, për një metër gjatësi (varësisht prej gjendjes së lëndës arkivore)10-30 €;

h) Përpilimi i listave të kategorive të dokumentacionit arkivor me afate të ruajtjes, për një faqe5 €;

i) Dhënia e ndihmës profesionale institucioneve jashtë planit të arkivit me kërkesë të poseduesit, për një orë.....20 €;

j) Pagesa e një eksperti të arkivit në ligjërrata në institucion, me kërkesë të tyre, për një ligjërratë.....100 €;

k) Përgatitja e materialit profesional për menaxhim zyrtar e arkivor të institucionit/organizatës, për një faqe5 €;

l) Përgatitja e një kutie arkivore për fonde-krijuese, sipas kërkesës së tyre.....5 €;

m) Digjitalizimi i mikrofilmave për nevoja shkencore, për një mikrokuadër të digjitalizuar0,10 €;

n) Printimi i një faqeje nga kompjuteri i dokumenteve të digjitalizuara.....0,10 €;

o) Dorëzimi i dokumentacionit në formë digjitale.....0,05 € + CD 1 €.

3. Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”:

a) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme pa zërim, pa dekor, por me ngrohje (gjatë dimrit) 50.00 €, paushall 100.00 €;

b) Një orë e organizimit dhe tubimeve të ndryshme me zërim, dekor (materiali i organizatorit, puna kryhet nga stafi), ngrohje (gjatë dimrit) 100.00 €, paushall 200.00 €;

c) Për entitetet jopublike për shfaqjen e koncerteve dhe shfaqjeve teatrale, organizatori duhet të paguajë 30% nga numri i biletave të shitura në këto raste. Çmimin e biletës e cakton organizatori, kurse Qendra për Kulturë obligohet të

sigurojë kushtet e nevojshme: sallën, zërimin ngrohjen, shitjen e biletave, CD plajerin;

- d) Për një shfaqje teatrale për të cilën caktohet pagesë hyrëse, bileta për të rritur kushton një (1) €, ndërsa për fëmijë kushton zero pikë pesëdhjetë (0.50) €, dhe inkasimi i këtyre të hyrave barten në xhirrollogarinë e Komunës së Vushtrrisë. Mirëpo, ka raste kur shfaqjet realizohen pa pagesë hyrëse për të interesuarit, varësisht se si vendos DKRS-ja;
- e) Nga pika “d” lirohen nga pagesa të gjithë vullnetarët, të cilët janë të pajisur me libreza të vullnetarizmit;
- f) Nëse organizatori zgjedh formën paushall, pagesa do të kushtojë 50.00 € dhe pagesën duhet ta bëjë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës;
- g) Shfrytëzuesi i sallës dhe shërbimeve tjera është i obliguar që të bëjë caktimin e terminit 48 orë para fillimit të shfaqjes apo programeve të ndryshme;
- h) Lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirës-salla e madhe e QK “Hasan Prishtina”, si vijon: tubimet e organizuara nga komuna, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (Dega në Vushtri), shoqata “HANDIKOS”, organizatat rinore dhe të ngjashme, të cilat nuk kanë karakter përfitues.

Neni 19 **Tarifa në sferën e sportit**

- 1. Pagesat për shfrytëzim të Palestrës së Sporteve janë si vijon:
 - a) Për 90 min. stërvitje për shkollat sportive (private)
 - 1) me ndriçim6.00 €;
 - 2) pa ndriçim.....3.00 €.
 - b) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive (meshkujt)
 - 1) me ndriçim.....12.00 €;
 - 2) pa ndriçim.....10.00 €.

- c) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive (femrat)
- 1) me ndriçim.....10.00 €;
 - 2) pa ndriçim.....8.00 €.
- d) Ndeshjet sportive me bileta deri në 400 shikues:
- 1) meshkujt.....50.00 €;
 - 2) femrat.....40.00 €.
- e) Ndeshjet sportive me bileta mbi 400 shikues:.....20% nga shitja e biletave.
- f) Për 90 min. stërvitje për klubet sportive private:
- 1) me ndriçim.....14.00 €;
 - 2) pa ndriçim.....12.00 €.

2. Ndeshjet sportive me bileta (mbi 400 shikues), 20 % nga shitja e biletave:

- a) për 60 min. për rekreacion për aktivitete të lira:
- 1) me ndriçim.....12.00 €;
 - 2) pa ndriçim.....10.00 €.
- b) Për shfrytëzimin e palestrës për turnir, për një orë 5 € (gjysmëfinalja dhe finalja plus 30% nga shitja e biletave);
- c) Për shfrytëzimin e palestrës për ngjarje kulturore për një orë.....50.00 €;
- d) Ngjarjet kulturore ku ka shitje biletash mbi 500 bileta, 30 % nga shitja e biletave;
- e) Turniret, kampionatet kombëtare e ndërkombëtare në marrëveshje me organizuesin 30 % nga shitja e biletave;
- f) Për shfrytëzimin e terreneve tjera sportive, për një ndeshje kampionate apo për kupë..... 250 €;
- g) Nga pagesat e përmendura të nenit 18 pika 2 të kësaj rregulloreje, lirohen: klubet sportive publike të Komunës së Vushtrrisë; shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (të Komunës së Vushtrrisë), FSK për dy termine në javë, nga një orë

pa pagesë për dy termine brenda javës; shoqata “HANDIKOS” për një termin brenda javës; manifestimet dhe tubimet e organizuara nga ana e Komunës së Vushtrrisë; SHPKF dhe SSH për organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore në nivel komunal, regjional dhe republikan; SHPK; bashkësitë fetare; shoqatat dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse, të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë.

h) Shfrytëzimi i Palestrës Sportive, për tubime dhe organizime të ndryshme pa zërim dhe dekor:

1) 60 min.....80.00 €;

2) paushall.....150.00 €.

3. Salla e sporteve luftarake

a) Për 90 min- stërvitja për klubet sportive publike:

1) me ndriçim.....8.00 €;

2) pa ndriçim.....4.00 €.

b) Për 90 min- stërvitja për klubet sportive private:

1) me ndriçim.....8.00 €;

2) pa ndriçim.....4.00 €.

c) Për një orë rekreacion:

1) me ndriçim..... 8.00 €;

2) pa ndriçim.....4.00 €.

4. Salla e ping-pongut:

a) Për 90 min.- stërvitja për klubet sportive publike:

1) me ndriçim.....4.00 €;

2) pa ndriçim.....2.00 €.

b) Për 90 min.- stërvitja për klubet sportive private:

1) me ndriçim.....6.00 €;

2) pa ndriçim.....3.00 €.

c) Për 60 min. rekreacion:

1) me ndriçim.....4.00 €;

2) pa ndriçim.....2.00 €.

5. Për shfrytëzimin e Palestrës së Sporteve lirohen nga pagesa klubet sportive të komunës, që garojnë në ligen e parë dhe Superligën e Kosovës.

Neni 20

Tarifat për subjektet e interesuara që iu mundësohet vendosja e reklamave të tyre

1. Vendosja e reklamave me dimensione për një muaj:

a) Në qendrën e fushës së basketbollit në parket.....40.00 €;

b) Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit.....20.00 €;

c) Në hapësirën e 6 metërshit të fushës së hendbollit -//2 X 0.60 m.....20.00 €;

d) Në hapësirën brenda f.së basketbollit dhe hendbollit-//2 X 0.60 m.....20.00 €;

e) Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit-//3 X 0.60 m.....20.00 €;

f) Në pjesën anësore (lindje dhe perëndim) të pallatit 2 X 0,80 m.....20.00 €;

g) Në pjesët tjera të palestrës, dimensionit 2 X 0.60 m.....10.00 €.

Neni 21

Kategoritë të cilat lirohen nga pagesa

1. Nga pagesa për shërbimet e kryera: për Certifikatë mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (fletë poseduese), kopje të planit, ndërsa për certifikata dhe vërtetime lirohen:

a) Familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së, invalidët e luftës së UÇK-së, veteranët e luftës së UÇK-së, si dhe familjet dhe individët përfitues të ndihmave sociale;

b) Lirimi nga taksa komunale, nga pika “a” do të bëhet pasi që pala-kërkuesi ta prezantojë dëshminë mbi statusin përkatës.

2. Tarifat për ofrimin e shërbimeve në sferën e gjeodezisë, kadastrit dhe pronës, janë të përcaktuara dhe do të llogariten – paguhen në bazë të; Udhëzimit Administrativ Nr.06/2008 – MSHP dt. 18.08.2008 për tarifën e shërbimeve dhe produkteve kadastrale, të ofruara nga zyrtarët kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodete të licencuara, si dhe të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2014 për tarifën e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme nga zyrtarët kadastrale komunale.

Neni 22 Tarifat në sferën e inspeksionit

1. Tarifa për pranime të lokaleve lidhur me kushtet teknike

Parashtruesi i kërkesës – subjekti ekonomik është i obliguar që pas konstatimit mbi plotësimin e kushteve minimale për lokalin afarist, në emër të shpenzimeve të procedurës inspektuese të paguajë shumën e caktuar në të holla, sipas hapësirës së objektit dhe atë:

| a) Tarifat për pranime teknik të lokaleve afariste | | |
|--|--|---------|
| 1.1. | Për lokalet afariste deri në 20 m ² | 10.00 € |
| 1.2. | Për lokalet afariste prej 21 m ² deri në 50 m ² | 20.00 € |
| 1.3. | Për lokalet afariste prej 51 m ² deri në 100 m ² | 40.00 € |
| 1.4. | Për lokalet afariste 101 m ² deri në 300 m ² | 50.00€ |
| 1.5. | Për lokalet afariste 301 m ² deri në 500 m ² | 100.00€ |
| 1.6. | Për lokalet afariste 501 m ² deri në 1000 m ² | 150.00€ |
| 1.7. | Për lokalet afariste mbi 1000 m ² | 200.00€ |

2. Pëlqimet Sanitare

| b) Tarifat për certifikatë, për pëlqime sanitare | | |
|--|--|---------|
| 2.1. | Për lokalet afariste deri në 30 m ² | 10.00 € |
| 2.2. | Për lokalet afariste prej 31 m ² deri në 50 m ² | 20.00 € |
| 2.3. | Për lokalet afariste prej 51 m ² deri në 100 m ² | 40.00 € |
| 2.4. | Për lokalet afariste mbi 100 m ² për m ² | 0.20 € |
| 2.5. | Për objekte banimi deri në 100 m ² | 20.00 € |
| 2.6. | Për objekte banimi prej 101 m ² deri në 200 m ² | 40.00 € |
| 2.7. | Për objekte banimi mbi 200 m ² për m ² | 40.00 € |

| | | |
|-------------|--|--------|
| 2.8. | Për objekte banimi mbi 200 m ² për m ² | 0.10 € |
|-------------|--|--------|

3. Tarifa për mallrat me afat të skaduar apo mallrat e dëmtuara, për asgjësim të tyre

c) Të gjitha subjektet afariste do të paguajnë tarifën dhe atë:

| | | |
|-------------|---|----------|
| 3.1. | Malli në peshë prej - 10,00 kg deri në 20,00 kg | 10.00 € |
| 3.2. | Malli në peshë mbi 20,00 kg deri 99,99 kg | 30.00 € |
| 3.3. | Në peshë prej – 100,00 kg deri 999,999 kg | 70.00 € |
| 3.4. | Në peshë prej - 1000 kg deri 10000 kg | 150.00 € |
| 3.5. | Mbi 10000 kg | 300.00 € |

4. Operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve: auto-taxi, operatorët taxi, kombibusët dhe autobusët për pranim të kushteve teknike për çdo automjet të tyre do të paguajnë tarifën:

- 4.1. Transportuesit e udhëtarëve – me autobus.....20.00 €;
- 4.2. Operatorët – taxi.....5.00 €;
- 4.3. Auto – taxi.....5.00 €;
- 4.4. Kombibusët.....10.00 €.

Neni 23

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Rregullorja zbatohet nën autoritetin e plotë të komunës dhe nën mbikëqyrjen e drejtorive kompetente.

2. Për të gjitha tarifën dhe ngarkesat e caktuara që nuk janë të parapara me këtë rregullore, do të aplikohen tarifën dhe ngarkesat e caktuara me ligj dhe udhëzime përkatëse.

Neni 24

Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen:

- 1. Rregullorja Nr. 330/12 dt. 27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale;

2. Vendimi Nr. 68/13 dt. 04.04.2013 për Ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
3. Vendimi Nr. 69/13 dt. 04.04.2013 për Ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
4. Vendimi Nr. 123/13 dt. 04.04.2013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
5. Vendimi Nr. 41/14 dt. 27.02.2014 për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
6. Vendimi Nr. 42/14 dt. 27.02.2014 për Plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
7. Rregullorja Nr. 20/15 dt. 29.01.2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01Nr.330/12 të datës 27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
8. Rregullorja Nr.69/15 dt. 26.03.2015 për Korrigjimin e Rregullores 01Nr. 20/15 dt. 29.01.2015.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Shpëtim Zhegrova
Kryesuesi i Kuvendit